



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 1891/15 prot.**

**Datë 10.03.2022**

**V E N D I M**

**Nr. 242/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.03.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF- 03078-08-17-2021, me objekt: “*Ndërtim rruga "Luz i Vogël" & "Rrethimi i Varrezave" Bathore*”, me fond limit 70,269,070 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK  
*Lagja “Zall Mner i Ri”, Rruga Nacionale Kamëz, Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kamëz.  
*Bulevardi “Nene Tereza”, nr.492, Kamez Tiranë.*

**Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK  
*Lagja "Kastrioti", Rruga "Andon Profka", 2 Kullat Fier,*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin*”

*dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.08.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-03078-08-17-2021, me objekt: “Ndërtim rruga “Luz i Vogël” & “Rrethimi i Varrezave“ Bathore”, me fond limit 70,269,070 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 30.09.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si vijon:

1. “Ndërtim Montimi Patos” SHPK	52,633,429.30 lekë,	skualifikuar
2. “Shendelli” SHPK	56,944,505.00 lekë	kualifikuar
3. “Almo Konstruksion” SHPK	62,783,556.25 lekë	kualifikuar

4. “Ulza” SHPK	68,795,200.00 lekë	skualifikuar
5. “Ndërtimi” SHPK	70,240,390.00 lekë	skualifikuar
6. “Kacdedja” SHPK	70,241,175.00 lekë	skualifikuar

II.3. Në datën 04.10.2021 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 06.10.2021 operatori ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK në procedurën e prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1891/2 date 07.10.2021, lidhur me kriteret e kualifikimit për të cilat ankimuesi “Almo Konstruksion” SHPK, ka ngritur pretendime për sa i përket ofertës së shoqërisë “Shendelli” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 9753 prot, datë 15.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1891/4 prot datë 20.10.2021, autoriteti kontraktor ka depozituar pranë KPP shkresën me lënde “*Informacion për shtyrje afati të trajtimit të ankesës nr. 9415 prot datë 06.10.201*”..

II.7. Në datën 10.11.2021, nëpërmjet shkresës nr. 1891/5 prot, me objekt: “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ankesës

II.8. Me shkresën nr. 9415/2 prot, datë 12.11.2021, protokolluar me tonën me nr. 1891/6 prot datë 18.11.2021, autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Në datën 02.12.2021, nëpërmjet shkresës nr. 1891/6 prot, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacion lidhur me punonjësen E.Balla, nëse rezulton e vetëpunësuar apo me punësim në kompani/institucione.

II.10. Me shkresën nr. 21700/1 prot, datë 20.12.2021, protokolluar me tonën me nr. 1891/8 prot datë 22.12.2021, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka bërë me dije Komisionin e Prokurimit Publik, se i nevojitet informacion shtesë për të siguruar të dhëna të sakta.

II.11. Në datën 24.12.2021, nëpërmjet shkresës nr. 1891/10 prot, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgoi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacion shtesë lidhur me punonjësen E.B.

II.12. Me shkresën nr. 21700/3 prot, datë 12.01.2022, protokolluar me tonën me nr. 1891/11 prot datë 17.01.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon Komisionin e Prokurimit Publik, për punësim/vetëpunësimin e znj.E.B.

II.13. Në datën 24.01.2022 nëpërmjet shkresës nr. 1891/12 prot, me objekt: “*Kërkesë për informacion*”, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me kërkesën si vijon:

*“Komisioni i Prokurimit Publik, në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga një operator ekonomik, i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës konstatojmë se nga një operator ekonomik, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, është deklaruar në datën 09.09.2021 me cilësinë e drejtuesit teknik Inxh.Gjeodezi, një punonjes i cili rezulton njëkohësisht i vetëpunësuar në aktivitetin “Agjencitë e pasurive të paluajtshme”, “Vlerësimi i pasurive të paluajtshme, punime inxh.gjeodezi, ndërtim”.*

*Sa më sipër, në zbatim të nenit 115, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” si dhe ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KPP ju drejtohet ju si institucion kompetent për një sqarim lidhur me faktin nëse i lejohet ligjërisht drejtuesit teknik të një kompanie që njëkohësisht të ushtrojë edhe aktivitetin e licensuar individual “Vlerësimi i pasurive të paluajtshme, punime inxh.gjeodezi, ndërtim”.*

Kjo kërkesë u ripërsërit nëpërmjet shkresës së KPP-së nr. 1891/13 prot., datë 11.02.2022.

II.14. Me shkresën nr. 776/2 prot, datë 23.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 1891/14 prot datë 24.02.2022, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka bërë me dije Komisionin e Prokurimit Publik, si më poshtë:

*“Në përgjigje të shkresave tuaja nëpërmjet të cilave parashtroni problematikën dhe njëkohësisht kërkoni opinion ligjor lidhur me sa kërkohet në ankesën administrative të paraqitur nga një operator ekonomik pranë Komisionit të Prokurimit Publik , shprehemi si më poshtë:*

*Në shkresat e përcjella nga ju informohemi se nga një operator ekonomik është deklaruar si drejtues teknik, inxhinier gjeodet, një punonjës i cili rezulton njëkohësisht i vetëpunësuar në aktivitetin “Vlerësim i pasurive të paluajtshme, punime inxhinier, gjeodet, ndërtim”. Si e tillë, kërkohet nëse i lejohet ligjërisht drejtuesit teknik të një shoqërie që njëkohësisht të ushtrojë edhe aktivitetin e licensuar individual “Vlerësim i pasurive të paluajtshme, punime inxhinier, gjeodet, ndërtim”.*

*Në Vendimin nr. 712, datë 12.10.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, përcaktohen rregullat dhe llojet e licencave që jepen për subjektet dhe individët në fushën në fjalë. Ndër të tjera, në këtë VKM parashikohet se:*

*“Licencë profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme”, është akti administrativ, që i njuh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrijë profesionalisht veprimtari”; dhe se “Për individët, licenca është e përhershme”.*

*Sa më sipër, dhënia e një licence në këtë fushë, nuk ka asnjë ndalim apo kufizim lidhur me sa parashtruar nga ana juaj.*

*Vlerësimi i pasurive të paluajtshme është një opinion i dhënë për një pronë, për të cilën i është kërkuar një ekspert i licencuar, dhe në këtë kuptim është një shërbim. Në mbështetje të ligjit nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, shërbim nënkuptohet çdo veprimtari ekonomike e kryer nëpërmjet vetëpunësimit, kundrejt një shpërblimi, si dhe çdo lloj veprimtarie me karakter intelektual, e zhvilluar në formën e sipërmarrjes apo në atë profesionale, në mënyrë të pavarur dhe kundrejt një shpërblimi.*

*Në bazë të dispozitës së mësipërme dhe, referuar informacionit të përcjellë, nga ana jonë vlerësohet se nuk ka asnjë pengesë lidhur me ushtrimin e këtyre aktiviteteve.”*

II.15. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua se operatori ekonomik “Shendelli” SHPK ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente, për të kundërshtuar pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion”, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” ShPK se: *“Nga operatori ekonomik “Shendelli ShPK” nuk është përmbushur pika 2.3.4. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Edhe po te kërkosh ne ueb rezulton qe nga OE Shendelli ShPK deklarohet ne çdo objekt qe konkurron i njëjti drejtues teknik rezident ne objekt Ing. Gjeodede –E Sako (Balla). Kërkojmë nga ana juaj te verifikohet nëse dhe për këtë objekt “Ndërtim rruga "Luz i Vogël" & "Rrethimi i Varrezave Bathore”, a është deklaruar kjo drejtuese teknike?. Sipas kriterëve te dhëna ne DST duhej deklaruar qe Drejtuesi Teknik nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.*

*Dëshirojmë t'ju bëjmë me dije qe nëse ekziston një deklaram i tille, përveçse i paplote është dhe i rreme, për arsye se inxhinierja e deklaruar rezulton qe te jete e vetëpunësuar si person fizik "Vlerësues” dhe ne këtë rast duhet te ishte deklaruar nga vete punonjësja. Po kështu, referuar njoftimeve ne buletin e prokurimeve publike rezulton qe e njëjta punonjëse është*

*deklaruar si drejtuese teknike bashke me te njëjtin staf dhe ne objektin "Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në kuadër të procesit të rindërtimit", ku ky operator është në JV me "NG Strukturës" SHPK & "G.P.G.Company" SHPK & "Shendelli" SHPK., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 7, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

*Në shtojcën 7/2, pika 2.3.4, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit"*

*2.3.4.Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Librezë pune*
- *Kontratë pune e vlefshme*
- *Diplomë*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "Shendelli" SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Deklaratë për drejtuesin teknik firmosur, vulosur nga operatori ekonomik, datë 09.09.2021, me përmbajtje si më poshtë:

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë 09/09/2021 nga Autoriteti Kontraktor: "Bashkia Kamez", me objekt: "Ndërtim rruga "Luz i Vogel" & "Rrethimi i Varrezave Bathore", me Fondi limit: 70.269.070 leke pa TVSH.*

*Unë i nënshkruari Y.Bozhaj me cilësinë Drejtues Ligjore të operatorit ekonomik "Shendelli" SHPK deklaroj se:*

*Do te kete drejtues teknik ne objekt: Ndertim rruga "Luz i Vogel" & "Rrethimi i Varrezave Bathore*

*1. Inxh. Gjeodede- E. Sako*

*Deklaroj se Drejtuesi Teknik nuk eshte i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Per cdolloj problemi ne kantier do te jete dhe drejtuesi ligjor, drejtuesit teknik te tjere do te vihen ne dispozicion sipas profesionit perkates. Inxhinieret kane pervoje pune mbi 30 vjet.*

2. Kontratë Pune lidhur më datë 20.09.2019 midis Punedhënesit "Shendelli" SHPK dhe Punëmarrësit E. Balla me nr. rep 1705 dhe kol 623., ku objekt i kesaj kontrate është punesimi si Drejtus Teknik .
3. Librezë pune e E.Balla (Sako)
4. Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik
5. Diplomë e Universitetit të Tiranës me titullin "Inxhinier Gjeodet" për znj.E.Balla.
6. Licencë "Për vlerësimin e pasurive të paluajtshme", lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për znj. E.Sako.
7. Licenca e shoqërisë "Shendelli" SHPK, ku një nga Drejtuesit Teknikë rezulton znj.E.Sako

III.1.4. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

*duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Lidhur me pretendimin e ankimesit se *“Sipas kriterëve të dhëna në DST duhej deklaruar që Drejtuesi Teknik nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Dëshirojmë t'ju bëjmë me dije që nëse ekziston një deklaram i tille, përveçse i paplote është dhe i rreme, për arsye se inxhinierja e deklaruar rezulton që te jete e vetëpunësuar si person fizik "Vlerësues" dhe në këtë rast duhet te ishte deklaruar nga vete punonjësja”,* rezulton se operatori ekonomik “Shendelli” SHPK ka deklaruar drejtues teknik ne objekt: Ndërtim rruga "Luz i Vogël" & "Rrethimi i Varrezave Bathore inxh. Gjeodede- E. Sako e cila nuk do të jetë e angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor të parashikuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu operatori ekonomik "Shendelli" SHPK ka paraqitur Kontratën e Punës, lidhur më datë 20.09.2019 midis Punëdhënësit “Shendelli” SHPK dhe Punëmarrësit E. Balla me nr. rep 1705 dhe kol 623., ku objekt i kësaj kontrate është punesimi si Drejtues Teknik; Librezën e punës së E. Balla (Sako); Dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik; Diplomën e Universitetit të Tiranës me titullin "Inxhinier Gjeodet" për znj. E. Balla; Licencën "Për vlerësimin e pasurive të paluajtshme", lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për znj. E. Sako; Licencën e shoqërisë "Shendelli" SHPK, ku një nga Drejtuesit Teknikë rezulton znj.E.Sako. Në këtë mënyrë dokumentacioni i paraqitur plotëson dhe tejkalon kërkesat e autoritetit kontraktor, parashikuar në dokumentet e tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit për drejtuesin teknik që do të ndjekë punimet.



Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.1.7. Për sa i përket argumentit të ankimuesit se *inxhinierja e deklaruar rezulton qe te jete e vetëpunësuar si person fizik "Vlerësues"*, nëpërmjet shkresës nr. 1891/12 prot, datë 24.01.2022 dhe nr. 1891/13 prot., datë 11.02.2022, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke i kërkuar sqarim lidhur me faktin nëse i lejohet ligjërisht drejtuesit teknik të një kompanie që njëkohësisht të ushtrojë edhe aktivitetin e licencuar individual *"Vlerësimi i pasurive të paluajtshme, punime inxh.gjeodezi, ndërtim"*. Në përgjigje të kërkesës së KPP-së, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 776/2 prot, datë 23.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 1891/14 prot datë 24.02.2022, ka sqaruar se referuar Vendimit nr. 712, datë 12.10.2016 të Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme"*, [...], dhënia e një licence në këtë fushë, nuk ka asnjë ndalim apo kufizim lidhur me sa është parashtruar nga ky Komision në shkresat e sipërcituara.

Vlerësimi i pasurive të paluajtshme është një opinion i dhënë për një pronë, për të cilën i është kërkuar një ekspert të licencuar, dhe në këtë kuptim është një shërbim. Në mbështetje të ligjit nr. 66/2016 *"Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë"*, shërbim nënkuptohet çdo veprimtari ekonomike e kryer nëpërmjet vetëpunësimit, kundrejt një shpërblimi, si dhe çdolloj veprimtarie me karakter intelektual, e zhvilluar në formën e sipërmarrjes apo në atë profesionale, në mënyrë të pavarur dhe kundrejt një shpërblimi. Në bazë të dispozitës së mësipërme dhe referuar informacionit të përcjellë, vlerësohet se nuk ka asnjë pengesë lidhur me ushtrimin e këtyre aktiviteteve.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë

III.1.8. Për sa i përket pretendimit të ankimuesit se: *"referuar njoftimeve ne buletin e prokurimeve publike rezulton qe e njëjta punonjëse është deklaruar si drejtuese teknike bashke me te njëjtin staf dhe ne objektin "Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në kuadër të procesit të rindërtimit", ku ky operator është ne JV me "NG Strukturës" SHPK & "G.P.G.Company" SHPK & "Shendelli" SHPK"*, bashkëngjitur me shkresën nr. 9415/ prot, datë 12.11.2021, me objekt: *"Dërgim vendimi"*, protokolluar me tonën me nr. 1891/6 prot datë 18.11.2021, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP, vendimin e Bashkisë Kamëz, lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik *"Almo Konstruksion" SHPK*, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Sipas autoritetit kontraktor *"Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka mbajtur procesverbalin nr.9737 prot., datë 15.10.2021 "Mbi zgjatjen e afatit të shqyrtimit të ankesës nr. 9415 prot., datë 06.10.2021 nga operatori ekonomik "Almo Konstruksion" SHPK për vlerësimin e ofertës së paraqitur në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur" me objekt: "Ndërtim rruga "Luzi Vogël" & "Rrethimi i Varrezave" Bathore, ne datë të mbylljes 09.09.2021" me qëllim dhënien e një vendimi sa më objektiv lidhur me pretendimin e lartpërmendur, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka kërkuar informacion pranë Bashkisë Kurbin për të verifikuar nëse znj. E. Sako figuron e deklaruar si Drejtuese Teknike në objektin: "Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në*

*kuadër të procesit të rindërtimit” dhe nëse afati i ekzekutimit të objektit të sipërcituar ka përfunduar apo është akoma në proces zbatimi.*

*Bashkia Kurbin me shkresën nr. 6292/1 prot., datë 03.11.2021 me lëndë: “Kthim-përgjigje shkresës nr. 9752 prot., datë 15.10.2021 “Kërkesë për informacion”, ka përcjellë informacionin duke cilësuar se: “ Në procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në kuadër të procesit të rindërtimit”, me nr.reference REF-79782-11-24-2020, nuk është e deklaruar si Drejtues Teknik znj. E. Sako. Gjithashtu ju informojmë, se operatori ekonomik “Shendelli” SHPK i ka realizuar 100% punimet në bazë të kontratës dhe ndarjes së punimeve.” Pretendimi i ofertuesit “Almo Konstruksion” SHPK nuk pranohet.”*

Sa më sipër cituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se verifikimi i kryer nga KSHA pranë autoritetit kontraktor Bashkia Kurbin, ka vërtetuar faktin, se Drejtuesi teknik i punimeve në objektin e mësipërm të prokurimit nuk është deklaruar si drejtues teknik në procedurën e prokurimit "Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në kuadër të procesit të rindërtimit”, pra njëkohësisht ky drejtues teknik nuk është i angazhuar në kontratat të tjera, siç pretendon ankimuesi, duke vërtetuar edhe njëherë se deklarimi i operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK nuk është një deklaram i rremë. Referuar pretendimeve dhe provave shkresore të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, informacionit të autoritetit kontraktor, si dhe verifikimeve të kryera nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik rezulton, se shoqëria “Shendelli” SHPK plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për drejtuesin teknik të punimeve.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Almo Konstruksion” ShPK se: *“ Nga informacionet që kemi rezulton që operatori ekonomik "Shendelli ShPK" nuk është përmbushur pika 2.3.6, krahas stafit të mësipërm të ketë të punësuar staf mbështetës 2 (dy)punonjës teknik ndërtimi dhe 1 (një) punonjës teknik topograf. Rezulton që operatori ekonomik "Shendelli ShPK" ka bere deklaram të rremë për qellim kualifikimi ne lidhje me stafin pasi:*

*Nga shoqëria “Shendelli” eshte deklaruar se stafi teknik i poshtëshënuar nuk janë të angazhuar ne kontrata te tjera apo punëmarrje tjetër.*

- *Z.A R., me profesion Teknik Ndërtimi i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknikut të Ndertimit.*
- *Z. V. A., me profesion Teknik Ndërtimi i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknikut të Ndertimit.*
- *Z.Xh. R., me profesion Teknik Topograf i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknikut Topograf.*
- *Z. Th. Ll., me profesion Ing. Gjeolog i pajisur me certifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”.*
- *Z.F.R, me profesion Elektracist i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Elektracistit.*

- *Z.Xh.M., me profesion Elektracist i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Elektracistit.*

*Nga verifikimet e kryera nga ana jone rezulton qe ky deklarim është i rreme, parashikuar nga neni 76 i LPP-se, "Kriteret detyruese për skualifikim", pika 3/ë, "Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit"; pasi:*

*A. R., deklaruar nga Shendelli ShPK si "Teknik ndërtim/inxhinieri civile", rezulton te jete i punësuar me kohe te plote pranë shoqërisë LENTIN 2015 si "Shofer autobusi".*

*V. A., deklaruar nga Shendelli ShPK si "Teknik ndërtim/inxhinieri civile", rezulton te jete i punësuar me kohe te plote pranë Ndërmarrjes se Shërbimeve te Mirëmbajtjes si "Punëtor krahu mirëmbajtje rrugësh".*

*Xh. R., deklaruar nga Shendelli ShPK si "Teknik topograf", rezulton te jete i punësuar me kohe te plote pranë Shoqërisë "Bare ShPK" si "Roje sigurimi".*

*Th. Ll., deklaruar nga Shendelli ShPK si "Gjeolog" i pajisur me certifikate "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune", rezulton te jete i punësuar me kohe te plote pranë Shoqërisë si PETRAX 170 si "Gjeolog" dhe po kështu pranë Shoqërisë "Pirali ShPK" si "Inxhinier/drejtues teknik në shfrytëzim".*

*F. R., i deklaruar si punonjës me profesion Elektracist i punësuar pranë shoqërisë "Shendelli", në rolin e Elektracistit, rezulton sipas listëpagesave qe është i punësuar si "suvatues".*

*Xh. M., i deklaruar si punonjës me profesion Elektracist i punësuar pranë shoqërisë "Shendelli", në rolin e Elektracistit, rezulton sipas listepagesave qe është i punësuar si "punëtor duralumini". Po kështu ky punonjës rezulton te jete i punësuar pranë shoqërisë AR&ED ShPK si "punëtor krahu"..*

*Bazuar ne nenin 78 te LPP-se, "Përrjashtimi për një periudhë të caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik", pika 1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi..[...]*Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1 . Në shtojcën 7, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

Në shtojcën 7/2, pika 2.3.6, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" është kërkuar:

2.3.6.Krahas stafit te mesiperm te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- 2 (dy) punonjës teknik Ndërtimi
- 1 (nje) punonjës teknik Topograf

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe diploma e shkolles se larte / ose diploma e shkolles profesionale per secilin punonjes. Staf i mësipërm te figuroje ne listepagesat e shoqërisë.*

**Stafi i kerkuar te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen kohore Shkurt – Korrik 2021**

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjesit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.*

*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*

Në shtojcën 7/2, pika 2.3.6, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" është kërkuar:

**2.3.7. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:**

- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikuar **"Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave"** e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si **"Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune"** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

*Për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet te paraqesë diplomë/ Certifikatat e cituara më sipër*

Në shtojcën 7/2, pika 2.3.8, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" është kërkuar:

**2.3.8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listepagesat e subjektit punonjesit specialistë të kualifikuar, me deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik (të vlefshme) përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, si më poshtë:**

- 2(dy) punonjës elektrikist
- 2(dy) punonjës hidraulik
- 2(dy) punonjës karpentier

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik "Shendelli" SHPK në përmbushje të kriterëve sa më sipër, për sa i përket dy punonjësve teknik ndërtimi, një punonjës që disponon certifikatën si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", një punonjës teknik topograf dhe dy punonjësve elektrikist, ka paraqitur të plotësuar shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", sipas të cilës shoqëria "Shendelli" SHPK deklaroi punonjësit si vijon:

- Z.A.R, me profesion teknik ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknikut te Ndertimit.
- Z.V A, me profesion Teknik Ndertimi i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknikut te Ndertimit.

- Z.Xh. R, me profesion Teknik Topograf i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Teknikut Topograf. [...]
- Z. Th. Ll ,me profesion Inxh Gjeolog i pajisur me certifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”.
- Z.F. R, me profesion Elektricitist i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Elektricitistit.
- Z.Xh. M, me profesion Elektricitist i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Elektricitistit.

Për punonjësit e sipërcituar, operatori ekonomik “Shendelli” SHPK, ka paraqitur dokumentacionin përkatës, që vërteton disponimin e tyre, siç kërkohet në dokumentet e tenderit.

III.2.3. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të*

*njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.2.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues se: *“Nga informacionet që kemi rezulton që operatori ekonomik “Shendelli ShPK” nuk është përmbushur pika 2.3.6, krahas stafit të mësipërm të ketë të punësuar staf mbështetës 2 (dy)punonjës teknik ndërtimi*

dhe 1 (një) punonjës teknik topograf”, rezulton se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar 2 (dy) punonjës teknik Ndërtimi dhe 1 (një) punonjës teknik Topograf, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe diploma e shkollës së lartë / ose diploma e shkollës profesionale për secilin punonjës dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën kohore Shkurt – Korrik 2021.

*Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjesit në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.*

Rezulton, se operatori ekonomik “Shendelli” SHPK ka deklaruar në ofertën e tij, nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, se ka të punësuar Z.A.R, dhe z.V A me profesion teknik ndërtimi, dhe Z. Xh. R, me profesion Teknik Topograf. Përveç vetëdeklarimit në ofertë është paraqitur edhe dokumentacioni që vërteton se këta punonjës janë të punësuar pranë kësaj shoqërie. Konkretisht: për z. A. R është paraqitur kontrata e punës, e lidhur në datën 29.08.2020 me shoqërinë ”Shendelli” SHPK për një afat 5-vjeçar, për të punuar si teknik ndërtimi, dokumenti që vërteton përfundimin e Shkollës së Mesme të Ndërtimit, lëshuar nga Ministria e Arsimit, si dhe licencë Z.4XX4, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për dhënien e titullit ”Teknik Ndërtimi” për z. A. R. Gjithashtu ky punonjës figuron në listëpagesat e shoqërisë për gjithë periudhën e kërkuar.

Për z. V. A.i është paraqitur kontrata e punës, e lidhur në datën 08.06.2019 me shoqërinë ”Shendelli” SHPK për një afat 10 vjeçar, për të punuar si teknik ndërtimi; Dokumenti që vërteton përfundimin e Shkollës së Mesme të Ndërtimit, lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës; Dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik, profesioni ”Teknik Ndërtimi” si dhe Libreza e punës, ku rezulton ”teknik ndërtimi”. Gjithashtu ky punonjës figuron në listëpagesat e shoqërisë për gjithë periudhën e kërkuar.

Për z. Xh. R. është paraqitur kontrata e punës, e lidhur në datën 24.03.2020 me shoqërinë ”Shendelli” SHPK për një afat 10 vjeçar, si teknik topograf; Dokumenti që vërteton përfundimin e Shkollës së Mesme të Ndërtimit, lëshuar nga Ministria e Arsimit; Dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik, profesioni ”Teknik Topograf”, si dhe Libreza e punës, ku rezulton ”teknik topograf”. Gjithashtu, ky punonjës figuron në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar.

Për sa më sipër cituar, duke qenë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt-shqyrtimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Shendelli” SHPK provon, se i ka të punësuar dy punonjës teknik Ndërtimi dhe një punonjës teknik Topograf, në përputhje dhe në tejkallim të kërkesave të autoritetit kontraktor si më sipër cituar.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2.6. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “(Nga shoqëria “Shendelli” SHPK është deklaruar se stafi teknik i poshtëshënuar nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera apo punëmarrje tjetër A R, deklaruar nga Shendelli ShPK si “Teknik ndërtim/inxhinieri civile”, rezulton te jete i punësuar me kohe te plote pranë shoqërisë LENTIN 2015 si “Shofer autobusi”. V A, deklaruar nga Shendelli ShPK si “Teknik ndërtim/inxhinieri civile”, rezulton

*te jete i punësuar me kohe te plote pranë Ndërmarrjes se Shërbimeve te Mirëmbajtjes si "Punëtor krahu mirëmbajtje rrugësh". Xh. R, deklaruar nga Shendelli ShPK si "Teknik topograf", rezulton te jete i punësuar me kohe te plote pranë Shoqërisë "Bare ShPK" si "Roje sigurimi". Th. Ll., deklaruar nga Shendelli ShPK si "Gjeolog" i pajisur me certifikate "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune", rezulton te jete i punësuar me kohe te plote pranë Shoqërisë si PETRAX 170 si "Gjeolog" dhe po kështu pranë Shoqërisë "Pirali ShPK" si "Inxhinier/drejtues teknik në shfrytëzim", rezulton se në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", të dokumenteve standarde të tenderit parashikohet që ofertuesi duhet të deklarojnë si vijon: "Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor."*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se personeli teknik i deklaruar nga operatori ekonomik "Shendelli" SHPK në këtë procedurë prokurimi si "Teknik ndërtimi", "Teknik topograf" dhe "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit ne pune", nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika "D" "Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera", pasi ky stafi teknik nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Gjithashtu, në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve, ndaj dhe autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.2.7. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: "F R, i deklaruar si punonjës me profesion Elektracist i punësuar pranë shoqërisë "Shendelli", në rolin e Elektracistit, rezulton sipas listëpagesave që është i punësuar si "suvatues"; Xh. M, i deklaruar si punonjës me profesion Elektracist i punësuar pranë shoqërisë "Shendelli", në rolin e Elektracistit, rezulton sipas listëpagesave që është i punësuar si "punëtor duralumini". Po kështu ky punonjës rezulton te jete i punësuar pranë shoqërisë AR&ED ShPK si "punëtor krahu"., rezulton, se në dokumentet e tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar shprehimisht se *operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit punonjësit specialistë të kualifikuar, me dëshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik (të vlefshme) përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licencuara nga organet përkatëse, si më poshtë: 2(dy) punonjës elektracist, 2(dy) punonjës hidraulik, 2(dy) punonjës karpentier.*



Për plotësimin e kërkesës së AK për punonjësit elektrikistë, operatori ekonomik “Shendelli” SHPK ka deklaruar në ofertën e tij, nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, se ka të punësuar z. F. R dhe z.. Xh. Mj me profesion Elektracist (krahas profesioneve të tjera). Përveç vetëdeklarimit në ofertë, është paraqitur edhe dokumentacioni që vërteton se këta punonjës janë të punësuar pranë kësaj shoqërie. Konkretisht: Për z. F. R është paraqitur kontrata e punës, e lidhur në datën 04.04.2020 me shoqërinë ”Shendelli” SHPK, për të punuar si suvatues, elektrikist, për një periudhë 10 vjeçare; Certifikata e trajnimit për elektrikist; Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, profesioni ”suatues-elektracist”. Për z. Xh. M është paraqitur kontrata e punës e lidhur në datën 04.04.2020 me shoqërinë ”Shendelli” SHPK për të punuar si specialist për prodhim dyer dritare duralumini dhe elektrikist, për një periudhë 10 vjeçare; Certifikatë trajnimi për elektrikist dhe Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, profesioni ”punëtor duralumini-elektracist”.

Gjithashtu këta ky punonjës figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar.

Për sa më sipër cituar, duke qenë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt-shqyrtimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Shendelli “SHPK provon, se i disponon dy punonjës me profesionin elektrikist, në përputhje dhe në tejkalim të kërkesave të autoritetit kontraktor si më sipër cituar.

Pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2018, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF- 03078-08-17-2021, me objekt: “Ndërtim rruga “Luz i Vogël” & “Rrethimi i Varrezave” Bathore”, me fond limit 70,269,070 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**